



Pranimi / Dorezuar Prilijeno / Pristato Received / Delivered	01. 12. 2021	viti god year	
Organ / Njësia Organ / Jednica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SHUMSHACK	5745/2021		1/3



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**  
**Nezavisni Nadzorni Odbor Civilne Službe Kosova**  
**Independent Oversight Board for the Civil Service of Kosovo**

Anr.836/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetare, Malsore Gashi dhe Arben Mehmeti-anëtarë dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën e datës 27.09.2021 të parashtruar nga ankuesi [ ] përmes Postës së Kosovës me numër R1768045, e pranuar me datë 29.09.2021 me numër A.nr.836/2021, me adresën zyrtare MD/PK-335D Qendra e Paraburgimit në Gjilan, kundër organit të punësimit Shërbimi Korrektues të Kosovës, në çështjen juridike **“masë disiplinore-vërejtje me shkrim”**, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 26.11.2021, mori këtë:

**V E N D I M**

- I. APROVOHET si bazuar** ankesa numër A.nr.836/2021 e datës 29.09.2021 e parashtruar nga ankuesi [ ]
- II. ANULOHET** Vendimi me numër protokolli 096/21 i datës 27.08.2021 i nxjerrë nga Drejtori të Qendrës së Paraburgimit në Gjilan, si dhe të gjitha vendimet tjera që rrjedhin nga ky vendim.
- III. OBLIGOHET** Drejtori i Përgjithshëm në Shërbimin Korrektues të Kosovës, për zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi, duke obliguar Udhëheqësin e Personelit të Shërbimi Korrektues të Kosovës/Udhëheqësin e Administratës dhe Personelit në Qendrën e Paraburgimit në Gjilan, që vërejtjen me shkrim ndaj ankuesit ta heq nga dosja personale e tij.
- IV.** Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

**A r s y e t i m**

Ankuesi [ ] i punësuar në Shërbimin Korrektues të Kosovës, në vendin e punës **“Zyrtar korrektuese”**, në Qendrën Paraburgimit në Gjilan, sipas kontratës së punës të datës 15.07.2020, i caktuar për kryerjen e detyrave të punës të Zëvendësuesit/Ndihmës/Mbikëqyrës Ndërrimi sipas Autorizimit nr.258A/20 të datë 20.04.2020, i është shqiptuar masë disiplinore-vërejtjes me shkrim me Vendimin me nr.096/21 të datës 27.08.2021 nga Drejtori i Qendrës së Paraburgimit në Gjilan, pasi ka pranuar raportin me shkrim të Komisionit Hetimor të datës 06.08.2021, për shkak se ankuesi ka neglizhuar punën e tij, me rastin e incidentit të vënies së zjarrit të datës 04.07.2021 rreth orës 01:20, nga ana e të burgosurit [ ] në dhomën 03 krahu L4, sepse të



burgosurin ankuesi, nuk e ka trajtuar me dinjitet, pasi ka pranuar njoftimin nga zyrtari korrektues i krahut L4, për incidentin.

Ankuesi kundër masës së shqiptuar vërejtjes me shkrim sipas Vendimit me nr.096/21 të datës 27.08.2021, të pranuar me datës 20.09.2021, ka parashtruar ankesë me datë 27.09.2021 përmes Postës së Kosovës me numër R1768045 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, e cila është pranuar me datë 29.09.2021 me numë protokollin 4811/21, me pretendime ankimore se vërejtja me shkrim i është shqiptuar pa vërtetuar gjendjen faktike dhe bazën juridike dhe vërejtja nuk i është shqiptuar nga Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i tij, dhe është në kundërshtim me nenin 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit për Zyrtar Publik, duke i propozuar Këshillit që t'ia aprovojë ankesën dhe të anulojë vërejtjen me shkrim.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, më datën 05.10.2021 e ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën tek Shërbimi Korrektues i Kosovës-Qendrës së Paraburgimit në Gjilan. Me datë 11.10.2021 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Shërbimi Korrektues i Kosovës - Qendrës së Paraburgimit në Gjilan, me shkresat e bashkëngjitura të lëndës nga 1/18 faqe.

Kolegji për marrjen e vendimit meritor administroj këto prova: Ankesën Anr.836/2021 me numër protokollin 4811/2021 të datës 29.09.2021, pliko/zarf postare e datës 27.09.2021 me numër R1768045, e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi nr.096/21 i datës 27.08.2021; Përgjigje në ankesë e datës 11.10.2021 me numër protokollin 4981/21; Autorizim i datës 20.04.2020 nr.258 A/20; Kontratë e punës e datës 15.07.2020; Hetimi i meningjtit të rastit të zjarrit të datës 05.08.2021 me nr. 085/21; Raporti përfundimtar i datës 03.08.2021; Kërkesë për prova shtesë, Përgjigje në kërkesë me datë 29.10.2021(E-maili).

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështjeje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka vërtetuar se ankesa e ankuesit **është e bazuar, sepse:**

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka analizuar provat e lëndës ka konstatuar se ankuesi ka statusin e nëpunësit civil bazuar në depozitën ligjore të nenit 4 paragrafit 1 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ku përcakton se: **“nëpunësit profesional të shërbimit korrektues janë nëpunës civilë me status të veçantë të cilët rregullohen me këtë ligj dhe me ligj të veçantë”**, ku marrëdhënia e punës rregullohet me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit i cili pretendon se shqiptimi i masës disiplinore -vërejtje me shkrim sipas Vendimit nr.096/21 të datës 27.08.2021 i nxjerrë nga Drejtori i Qendrës së Paraburgimit në Gjilan, lidhur me dyshimin se ankuesi nuk i ka zbatuar plotësisht detyrat e punës, sa i përket incidentit me rastin e vënies së zjarrit në dhomën e të burgosurit në krahun L4 nr.3, rreth orës 01:20 me datë 04.07.2021, gjithashtu ankuesi është konsideruar se të burgosurin nuk e ka trajtuar me dinjitet gjatë marrjes së masave për fikjen e zjarrit.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka analizuar pretendimet ankimore të ankuesit, ka konstatuar se pretendimet janë të qëndrueshme sepse Vendimi nr.096/21 i datës 27.08.2021 është nxjerrë nga Drejtori i Qendrës së Paraburgimit në Gjilan, i cili nuk është mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i ankuesit dhe është nxjerrë në kundërshtim me nenin 48 paragrafin 1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, ku përcaktohet se: **“1. Masa disiplinore e parashikuar në paragrafin 1.1 të nenit 47 të këtij ligji jepet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë”**, lidhur me faktin se provat e lëndës kanë vërtetuar se mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i ankuesit ka qenë UD. Mbikëqyrës i Lartë të cilën e ka vërtetuar dhe Njësia e personelit në Qendrën e Paraburgimit në Gjilan, sipas përgjigjes së datës 29.10.2021, të kërkuar me kërkesën e datës 29.10.2021 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, për të sqaruar strukturën organizative, në Qendrën Paraburgimit në Gjilan.



Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se Vendimi nr.096/21 i datës 27.08.2021, që në rastin konkret vërejtja me shkrim e shqiptuar ndaj ankuesit është nxjerrë nga Drejtori i Qendrës së Paraburgimit në Gjilan në kundërshtim me nenin 48 paragrafin 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-144 për Zyrtar Publik, ku përcaktohet se: **"Masa disiplinore e parashikuar në paragrafin 1.1 të nenit 47 të këtij ligji jepet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë"**, sepse Vërejtja me shkrim është dhënë nga organi jo kompetent, sepse, në bazë të nenit 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të këtij ligji, kjo kompetencë është vetëm e mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të ankuesit gjegjësisht e Mbikëqyrësit të Lartë të Qendrës së Paraburgimit në Gjilan, prandaj si e tillë nuk mundet të mbetet në fuqi.

Kolegji, si rrethanë faktike dhe ligjore për aprovim të ankesës ka marrë për bazë atë se Vërejtja është dhënë nga organi jo kompetent i cili duke i tejkualuar kompetencat e tij ligjore ka shqiptuar vërejtje me shkrim në kundërshtim me dispozitat e lartshënuara.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerr veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës dhe provave të ofruara nga palët, si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetari i Kolegjit me datë 12.11.2021 kishte bërë kërkesë për vazhdimin e afatit për vendimmarrje edhe për 10 ditë tek Kryesuesi i KPMSHCK-së për shkak të rrethanave të funksionimit të Këshillit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

## KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.836/2021,

**Eshref SHABANI**

Kryetar i Kolegjit

**Aydyl Bekteshi**

Procesmbajtëse

### Vendimi i dërgohet

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës dhe
- Udhëheqësit të Administratës dhe Personelit në Qendrën e Paraburgimit në Gjilan;
- Arkivit të KPMSHCK-së.